VENDIM
Nr. 146, datë 24.2.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE", NË BASHKINË E SKRAPARIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Zgjerimi i varrezave publike", në Bashkinë e Skraparit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Skrapar.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen për sipërfaqen e përgjithshme, prej 2 000 (dy mijë) m² truall, në vlerën 1 592 000 (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 592 000 (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekësh, përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Skrapar, planifikuar në buxhetin e saj.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale përballohet nga Bashkia e Skraparit.
6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë e Skraparit, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.
8. Regjistrimi i ri i pasurisë, prej 2 000 (dy mijë) m² truall, për projektin "Zgjerim i varrezave publike", bëhet në favor të Bashkisë së Skraparit.
9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia e Skraparit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE E PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË SHPRONËSIMIT QË DO TË PËRDORET PËR "ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE", NË BASHKINË E SKRAPARIT

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja m² truall	Çmimi në lekë/m²	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit të pronësisë
1	Selam Teki Koprencka	55/50	1420	1000	796	796 000	Certifikatë për vërtetim pronësie
2	Hektor Teki Koprencka	55/48	1420	1000	796	796 000	Certifikatë për vërtetim pronësie
	TOTALI					**1 592 000**	